



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër:463-01/60534,datë: 30. Korrik 2020.

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit nr.03/L-040 për vetqeverisje lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenet 24 dhe 25 të Ligjit mbi dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës Komunale Ligji nr.06/L-092, si dhe nenit 36 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.nr.09-8103 dt.29.09.2008 , pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtëshme komunale me pronen private të pronarit F&P Construction sh.p.k. me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt. 30 Korrik 2020, muarr:

V E N D I M

Nr. 37/2020

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE PËR REALIZIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN “QËNDRA, KAPESHNICA, PUHOVCI” NË PEJË

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtëshme komunale me pronen private të **pronarit personit juridik F&P Construction sh.p.k.nga Peja**, më qellim të formimit të shtegut të ecjes buzë lumit Lumbardh sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” në Pejë .

II. Për realizimin e këtij këmbimi sipas këtij Vendimi është propozuar që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës për interes publik rregullimin e rrugës Shtegut të Ecjes sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Karagaqi” në Pejë, për realizimin e këtij interesi publik Pronarit privat “F&P Construction” SH.P.K.” nga Peja për pronën private e cila gjëndet në ngastrën 2255 në sipërfaqe totale prej 374 m² ZK Pejë me 2/3 sipërfaqja prej 249 m², hapsira kah Lumbardhi që gjëndet në këtë ngastër i ofrohet në këmbim prona komunale 1308 në sipërfaqe prej 772 m² PSH e KK Pejë ZK Pejë pasi që këto ngastra pronë private janë në hapsirën ku sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” është paraparë projekti për shtegun e ecjes buzë lumit Lumbardh , si interes publik.

III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna në afat prej pesë ditëve e paraqet kërkesën për vlersimin e pronave të paluajtëshme sipas pikës II të këtij vendimi Zyrës për Vlersimin e pronës së Paluajtëshme pran Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1 MAPL-së
- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 DÇPJ
- 1x1 Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT

Dr. Islam Husaj